

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
NË OBJEKTIN E KERKIM
ZBULIMIT TE KROMIT “FUSHA E
VERVJAKUT”, BASHKIA BULQIZE,
QARKU DIBER.**



PER SHOQERINE: “TRE ORTAKET”SH.P.K,

Te dhëna te përgjithshme mbi kerkim zbulimin e vendburimit te kromit ""FUSHA E VERVJAKUT"

i.Formati përshkrues i zonës minerare për leje kërkim - zbulimi sipas akteve nënligjore të Ligjit Nr. 10304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar. Koordinatat e zonës së kërkuar për leje minerare kërkim-zbulimi, azhornuar në hartën topografike në shkallë 1: 25000 ka sipërfaqe 1.068 km², të projektuara në planin horizontal të pikave kufizuese jepen në tabelën e mëposhtme:

Nr. Pikës	Koordinatat	
	X	Y
1	4588381	4442910
2	4588380	4442640
3	4588410	4442640
4	4588410	4442220
5	4588610	4442220
6	4588610	4442020
7	4590238	4442020
8	4590238	4442452
9	4590010	4442452
10	4589712	4442585
11	4588987	4442390
12	4588987	4442913

Siperfaqja e zones minerale =1.068km²

Zonat e banuara me te aferta jane Ternova ne lindje dhe Nderfushas ne Perendim
Pershkrim i mbulesës bimore te sipërfaqes se propozuar per kryerjen e aktivitetit kërkim zbulimit

Ne kete objekt siperfaqja bimore eshte shume e varfer ku ka disa shkurre shume te vogla.

Informacion per pranine e burimeve ujore

INFOMACION PER PRANINE E BURIMEVE UJORE.

Percaktimi i sasise se ujit dhe menyres se largimit te tij

Per nga pikpamja hidrologjike dhe hidrografike objekti i kerkuar ndodhet ne kushte te mira.

Nuk vihen re burime natyrale ujrash.

NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDIS

Tokat

Tipi me i perhapur i tokave ne zone jane Tokat e Kafenjta Malore te cilat shtrihen ndermjet lartesisive 1500-1600 m mbi nivelin e detit.

Tokat e Kafenjta Malore formohen ne kushte te klimes mesdhetare malore dhe paramalore, me regjim hidrotermik te ndryshueshem. Nga pikepamja morfologjike dallohen per ngjyren e zeze, perbe en mekanike te rende dhe strukturen plisore. Ato kane bymim e tkurrjete larte,

ndersa filtrim te dobet. Keto toka karakterizohen nga permbajtje mesatare humusi, reaksion nga pak acid ne neutral, kompleks thithes te madh dhe saturim te larte me baza, kryesisht me Ca dhe Mg, horizont iluvial karbonatik, argjilim dhe ngjeshje ne horizontet e mesme te profilit. Formula e profilit eshte A-AB-B-BC-C ose A-AB-BC ose A-AC-C. *horizonti A* eshte siperfaqesor, rreth 30 em i trashe, me ngjyre te hlnjte kafe ose kafe te celet, tekstur subargjilore te mesme ne te rende, kokrrizore te paqendrueshme, ngjeshmeri mesatare deri ne te larte;

- **horizonti B** ka trashesi 40-80 cm, ngjyre te verdhe te murrme me nuanca te zverdhura dhe njolla ndryshku, teksture me te rende se horizonti A. Paraqitet i ngjeshur me strukture argjilore ose plisore dhe me permbajtje copash te formacioneve. Kalimi per ne horizontin C behet nepermjet horizontit kalimtar BC.

Nje lloj tjetër tokash qe haset ne zonen ne studim jane *Tokat e Murnne Pyjore* percaktohen si toka te maleve te mesme, te zones se pyjeve te ahut dhe pishes. Jane toka ne proces zhvillimi jo te avancuar, te pasura me minerale, me pritje argjilimi ne horizontet A dhe AB, me reaksion nga acid ne neutral. Pergjithesisht kane cilesi te mira fizike dhe pjellori potenciale te larte. Formula e profilit te ketyre tokave eshte AO-A-B-C ose AO-A-AB-C.

- **horizonti O** perfaqeson nje shtrese gjethesh te padekompozuara,
- **horizonti AO** perfaqeson lenden organike plotesisht te dekompozuar dhe te perzier me fazen minerale te tokes. Ai paraqitet si nje mase e bute dhe e fresket, me ngjyre te erret ne te zeze dhe trashesi 1-3 e deri 15 em,
- **horizonti A** eshte humusor, me trashesi deri ne 30cm, ngjyre kafe ose te murrme te erret, perbetje mekanike subargjilore te mesme dhe strukture kokrrizore,
 - **horizonti B** eshte iluvial, me trashesi rreth 50 cm ose dhe me shurne, me perbetje rnekanike me te rende se horizonti A per shkak te argjilimit dhe me strukture arnore ne plisore.

Ujrat siperfaqesore

Ne zonen e kerkuar rrjeti hidrografik eshte i perfaqesuar nga pjesa siperme e rrekeve e prroskave qe ne jug-perendim bashkohen duke krijuar perroin e Shares. Rreth zones ne nje distance prej 0.4 -0.5 km, nuk ka burime uji te pijshem. Ky rrjet eshte me uje te vazhdueshem, prurjet e te cileve ulen ne periudhen e veres. Nga punimet e kerkim zbulimit nuk preket liqeni i bardhe, i cili nuk eshte objekt i kerkimeve gjeologo minerare te kerkimit. Nga pikpamja hidrografike mund te themi se objekti ka kushte te favorshme pervec momentit te renies se rreshjeve, pasi ne nje kohe te shkurter ujrat largohen nga zona.

Ujrat nentokesore

Gjithashtu mund te themi se kushtet hidrogjeologjike te kesaje zone jane te thjeshta, pasi niveli i ujrave nentoksore eshte relativisht thelle dhe rrjeti hidrografik luan role pozitiv pasi sherben si drenues i ujrave, duke krijuar kushte te pershtateshme per kryerjen e punimeve te zbulimit sot dhe per ato te shfrytezimit ne te ardhmen.

Biodiversiteti

Zona karakterizohet nga diversitet i larte habitatesh, llojesh bimore e shtazore. Takohen pyje te ahut, pishes, rrobullit, bredhit, livadhe alpine, perrenj malore etj. Eshte e pasur edhe ne endemizma e subendemizma. Takohen gjitare te medhenj e te mbrojtur si ariu (*Ursus arctos*), ujku (*Canis lupus*), rreqebulli (*Felis lynx*), dhia e eger (*Rupicapra rupicapra*), gjeli i eger (*Tatrao urogallus*) dhe shqiponja (*Aquila chrysaetos*).

FLORA

Ne zonen e studimit jane verejtur tre tipe vegetacioni: shkurretat mesdhetare, pyjet e dushkut, pyjet e ahut, bredhit dhe pishes. Shkurretat mesdhetare jane kryesisht shkurre te perhereblerta p.sh. dredheza (*Arbutus unedo*) dhe mersina (*Myrtis communis*), shkurre te cilave u bien gjethet dhe peme mesdhetare. Pyjet e dushkut gjenden mbi zonen e shkurretave dhe perbehen nga pyje dushku ose pyje miks me dushk, shkoze, pise te zeze, geshtenje, frasher, panje dhe bli. Pyjet a ahut, bredhit dhe pishes jane speciet drunore mete zakonshme.

Florae pyjeve mesdhetare- Ne kete tip flore perfshihen pyjet me pise te eger si dhe dushkajat e perhereblerta dhe gjysmeperehereblerta. Flora barishtore eshte e pasur dhe perfaqesohet nga: *Dactylis glomerata L*, *Brachypodium pinnatum (L.) Beauv*, *Alyssum murale Waldst. et Kit.*, *Festuca heterophylla Lam*, *Teucrium polium L.*, *Aegilops geniculata Roth*, *Ononis spinosa L*, *Asphodelus aestivus Brat.*, *Helianthemum nummularium (L) Miller*, etj. Shumica e ketyre specieve jane kserofile. Kjo lidhet me faktin se pyjet e bulgrit rriten kryesisht ne shpate te thate e te ngrohte.

Florae zones se dushkajave- Ne kete kategori pyjore perfshihen pyjet e dushkajave gjetherenes dhe pyjet e kashnjeteve. Pyjet e dushqeve gjetherenes ne kete zone karakterizohen nga bunga (*Quercus petraea (Mattuska) Liebl*) dhe pyje me specie miks te dushqeve. Ne keto pyje mbizoterojne dushqet mezofile si bungebuta e shparthi. Dushkajat e formuara nga dushqe mezofile dhe gjysmemezofile jane pyje me hijezim me te madh se sa ato te formuara nga dushqe kserofile. Keshtuqe edhe florae tyre eshte me pak e pasur.

Ne katin shkurror takohen: Frasheri (*Fraxinus ornus L.*), Panja (*Carpinus orientalis Miler*), Dellinja (*Juniperus oxycedrus L.*), *Lembotropis nigricans (L) Greati*, *Crataegus monogyna Jacq*, *Colutea arborescens L.*, *Cotinus coggygria Scap*, etc. Keto dushkaja shoqerohen edhe nga shkurrja endemike boshtra - (*Forsythia europaea Deg. et Bald*). Variacione te shumta paraqet flora barishtore. Nder speciet me te zakonshme jane: *Dactylis glomerata L*, *Hellebonts odonts Ealdst et Kit.*, *Digitalis grandiflora Miller*, *Lotus corniculatus L*, *Lathyrus venetus (Miller) Eohlf*, *Achillea millefolium L.*, *Bellis perennis L.*, *Melitis melissophyllum L*, *Ajuga reptans L*, *Geranium robertianum L*, *Filipendula vulgaris Moench*, etc.

Zona te Mbrojtura dhe Monumentet e Natyre

Zonat e mbrojtura bashke me monumentet e natyres perfaqesojne nje rrjet siperfaqesh qe mbrohen ne shkalle te caktuar, sipas percaktimeve kategorike te tyre, per shkak te vlerave natyrore kombetare, por edhe rajonale e globale.

Zona ne te cilen propozohet te zbatohet projekti nuk nderpret asnje zone te mbrojtur.

Metodika e aplikuar per vleresimin ndikimeve ne mjedis

Çdo aktivitet qe zhvillohet ne mjedis shoqerohet me pasoja dhe ndikime qe jane pjese e atij kompromisi qe shoqeria jane ka zgjedhur per t'u zhvilluar. Megjithate e rendesishme eshte qe te kuptohet natyra e ketyre proceseve; forma e shfaqjes se tyre, dhe ne mi nyre me analitike ndikimet e çdo operacioni te kryer, sidomos mbi burimet natyrore te rinovueshme.

Vleresimi i ndikimeve te mundshme si pasoje e veprimtarise behet duke u nisur nga nje sere faktoresh qe lidhen me natyren e veprimtarise, teknologjine e perdorur, menyren e operimit, sasine e energjise, lendet e para te perdorura dhe mbeljet e gjenerura, te gjitha keto ne

kontekstin e mjedisit fizik, biologjik dhe socio-ekonomik.

Per nje vleresim sa me profesional te ndikimeve dhe pasojave te projektit ni:mjedisin fizik dhe social eshte perzgjedhur te aplikohet metodika dhe procedura e meposhtme:

- Identifikimi dhe njohja e te gjithë aktiviteteve te projektit;
- Identifikimi i ndikimeve te mundshme dhe me pasoja te rendesishme ne mjedis per cdo aktivitet, kjo bazuar edhe ne studimin e gjendjes se mjedisit dhe projektit teknik;
- Krahasimi i ndikimeve te mundshme me kushtet dhe gjendjen egzistuese te zonave te projektit;
- Vleresimi dhe kategorizimi i c;do ndikimi te mundshem dhe te identifikuar duke perdorur matriksin e kategorizimit me poshte;
- Zhvillimi i nje materiali te permbledhur ku sqarohet menyra e vleresimit dhe kategorizimit te ndikimeve te mundshme te projektit.

Per te ndjekur nje rrjedhe logjike te vleresimit te ndikimeve ne mjedis, te paraqitur me ane te tabelave te meposhtme, procesi eshte konceptuar ne faza qe perkojne me fazat e projektit dhe konkretisht,

1. ne fazen pergatitore dhe kryerjen e punimeve te zbulimit;
2. ne fazen e shfrytezimit;
3. ne fazen e mbylljes, rehabilitimit te objekteve dhe riaftesimit te proceseve natyrore.

Raporti i Vleresimit te ndikimit ne Mjedis identifikon llojet e meposhtme:

- Ndikimet negative;
- Ndikime pozitive;
- Ndikimet e drejtperdrejta qe vijne nga operacionet qe jane pjese perberese e aktivitetit;
- Ndikimet jo te drejtperdrejta te cilat jane te dukshme dhe shkaktojne efekte ne nje tjetër drejtim;
- Ndikimet kumulative, te dukshme, te krijuara nga akumulimi i efekteve te dukshme ne nje zone te veçante, rishfaqja e efekteve te disa llojeve ne zona te ndryshme, ose bashkeveprim te efekteve te ndryshme per shume kohe ose nga kombinimi i efekteve te ardhura si pasoje e bashkeveprimit me projekte te tjere te mundshem.

Eshte e rendesishme te kuptohet natyra e ketyre proceseve dhe forma e shfaqjes se tyre, direkte ose indirekte, ne menyre qe te percaktohet qarte lloji i ndikimeve:

•Ndikime te kthyeshme ne mjedis,

•Ndikime te pakthyeshme ne mjedis.

Metodika e kategorizimit te ndikimeve te identifikuara (sinjifikanca)

Per te percaktuar me mire masat per kontrollin dhe minimizimin e ndikimeve negative te identifikuara gjate procesit te VNM dhe per te ndihmuar vendimmarrjen e organeve kompetente, ne kete paragraf eshte bere nje kategorizim i rendesise se çdo ndikimi te mundshem negativ ne mjedis te aktivitetit te propozuar. Ky kategorizim eshte kryer bazuar ne vlerat mjedisore te zones, legjislacionin mjedisor ne fuqi dhe njohurite mbi teknologjine dhe tekniken e kryerjes se operacioneve ndertimore.

Per te hartuar matricen e kategorizimit te ndikimeve u ndoqen hapat e meposhtem:

1. Identifikimi i te gjithë aktivitetëve të projektit dhe grupimi i tyre sipas fazave të zbatimit (parapergatitore, operacionale).
2. Identifikimi i faktoreve mjedisore dhe grupimi i tyre sipas karakteristikave fizike, biologjike, socioekonomike dhe arkeologjike.
3. Perzgjedhja e receptoreve mjedisore me te rendesishem per aktivitetet e projektit te propozuar.
4. Percaktimi i nje sistemi vleresimi me pike per ndikimet (p.sh. numra,shkronja,ngjyra).
5. Plotesimi i matrices me piket dhe shenimet qe identifikojne dhe permbledhin ndikimet.

Metodika e vleresimit te rendesise se ndikimeve te mundshme negative ne mjedis

D.LDENTIFIKIMIDHE VLERESIMI/KATEGORIZIMIINDIKIMEVE

Identifikimi dhe vleresimi / kategorizimi i ndikimeve					
Zona e influences se projektit					
E pandikuar (0)	Ndikim i drejtperdrejte (1)		Ndikim i drejtperdrejte dhe indirekt (2-3)		Ndikim i drejtperdrejte dhe indirekt dhe rajonal(4-5)
Mundesia qe te ndodhe ndikimi					
I izoluar (0)	Shume i ulet (1)	I ulet (2)	Mesatar(3)	I larte (4)	I pasigurt (5)
Kohezgjatja e ndikimit					
Ore ne dite (0)	Dite ne jave(1)	Jave ne muaj(2)	Muaj ne vite (3)	Vite ne dekada(4)	I perhershem (5)
Shkalla /rendesia e ndikimit (sa e rendeshishme eshte pasoja e tij)					
I parendesishem (0)	Shume pak i rendesishem (1)	Pak i rendesishem (2)	Mesatar (3)	I larte (4)	Shume i larte (5)
Llojet e ndikimit (pasojat e tij)					
Pozitiv (P)		I pasigurte (U)		Negativ (N)	
Mundesia per te zbutur ndikimet					
Zbutje e plote(0-1)	Zbutje e plote me veshtiresi(2)	Zbutje e pjesshme(3)	Zbutje e pjesshme me veshtiresi(4)	Zbutje e pamundur(5)	

Kualifikimi /kategorizimi total i ndikimit					
I paperfillshem (0)	Shume i ulet (1)	I ulet (2)	Mesatar (3)	I larte (4)	Shume i larte (5)

Zona e influences se projektit

Zona e ndikimit (e influences)-Tregon shtrirjen ne hapsire te ndikimit. Zonat nen influencen e projektit jane kategorizuar si vijon; e pandikuar, e ndikuar drejtperdrejte (ndikimi brenda kufijve hapsinore te zones se projektit), ndikim jo i drejtperdrejte (indirekt) (ndikimi ne receptor ne zonen e projektit}, ose rajonal (ndikimet ne receptor jashte zones se projektit). Vleresimi varian nga shkalla me e ulet 0 deri ne 5, me zgjerimin apo rritjen e zones se influences.

Mundesia qe ndikimit te ndodhe (probabiliteti) -Shpreh mundesine qe ndikimi te ndodhe si pasoje e zbatimit te projektit. Kategorizimi i mundesise jepet: i pamundur/i izoluar (0), shume i ulet (1), i ulet (2), mesatar (3), i larte (4), dhe i pasigurte (5).

Kohezgjatja -Shpreh zgjatjen ne kohe te ndikimit te mundshem: ore ne dite (0), dite ne jave (1}, jave ne muaj (2), muaj ne vite (3), dhe vite ne dekada (4). Nese ndikimi zgjat shume ne kohe ose pa kufizim ne kohe atehere ai konsiderohet i perhershem (5).

Ashpersia/rendesia e ndikimit-Shpreh/vlereson rendesine apo sa e rendesishme eshte pasoja e ndikimit ne receptorin respektiv, ky element u kategorizua: i parendesishem (0), shume pak i rendesishem (1}, pak i rendesishem (2), mesatar (3), i larte (4) dhe shume i larte (5). Prania e ndikimeve egzistuese u mor ne konsiderate gjate kategorizimit te ndikimeve te projektit per te qene sa me objektiv ne kontributin real te ndikimeve te projektit.

Llojet e ndikimit -Shpreh llojet e ndikimit te identifikuar dhe i cileson ato si pozitive (P), te pasigurta mbi llojin e ndikimit dhe pasojes se tij ne receptor (U), ose negativ (N) kur pasoja e tij eshte e demshme.

Mundesia per zbutjen e ndikimeve -Shpreh mundesine qe nje ndikim i identifikuar te zbutet (pra te reduktohet sa me teper pasoja e tij negative ne receptor, terma kohore, teknike dhe financiare). Zbutja e ndikimit arrihet nepermjet parandalimit te tij ose nderhyrjes me masa menaxhuese dhe ne ketekontekst kategorizimi i mundesise per zbutjen e ndikimeve jepet si: zbutje totale (0-1), zbutje totale por me veshtiresi (2), zbutje e pjesshme (3), zbutje e pjesshme me veshtiresi (4), zbutja e ndikimit eshte e pamundur (5).

Kategorizimi total/perfundimtar/i plote i ndikimit - Eshte nje shumatore e te gjithë kategorizimeve si me sipër te nje ndikimi te dhene dhe pasqyrohet si: i paperfillshem (0), shume i ulet (1), i ulet (2), mesatar (3), i larte (4), shume i larte (5). Kategorizimi perfundimtar u realizua nepermjet mbledhjes se pikeve mesatare te r;do kategorizimi te ver;ante te nje ndikimi te caktuar. Lloji i ndikimit perckaton vetem nese ndikimi eshte negativ apo pozitiv apo i pasigurte per pasojen dhe prandaj nuk perfshihet ne kategorizimin total.

Ne matricen e kategorizimit/analizimit te ndikimeve, ndikimet pozitive jane shenuar me "+," te pasigurtat me "+/-" dhe negativet "-."

Seksionet ne vijim pershkruajne analizimin e ndikimeve dhe kategorizimin e tyre sipas modelit tabelar matricor.

Identifikimi i ndikimeve te mundshme sipas receptoreve te mjedisit

Ndikimet e mundshme te identifikuara per zonen e projektit te propozuar jane paraqitur te

kategorizuara. Gjate kategorizimit u moren parasysh edhe skenari me i keq I mundshem sa i takon ndikimeve negative dhe pozitive te projektit.

Tabela paraqet ndikirnet e mundshme te projektit ne receptore te ndryshem te mjedisit. Sidoqofte ndikimet mund te zbuten dhe te jene me te parendesishem nga sa kategorizohen ne tabele, kjo ne varesi te efekeve te masave zbutese qe do te zbatohen. E kunderta mund te jete gjithashtu e mundur.

Matrica e kategorizimit te ndikimeve

Aktiviteti	Ndikimi	zona e ndikimit	Mundësia qe te ndodhe	Kohezgjatja	Shkalla e ndikimit	mundësia e zbutjes	Totali
Rilevimi topografik	Nuk shoqerohet me ndikime						
Rilevimi gjeologjik	Nuk shoqerohet me ndikime						
Punime minerare (kanale, galeri dhe shpime)	Toke- Ndryshim i destinacionit te perdorimit, zhvendosje e tokes nga germimi (gjenerim masash shkembore dhe dherash), ngjeshje, humbje ne pjerresine e tokes dhe erozion ne zonat e kryerjes se punimeve minerare	3	2	3	2	-2.2	
	Ajer- Zhurme, gjenerim pluhuri, çlirim i gazeve nga makinerite dhe vibrime ne zonat e kryerjes se punimeve minerare dhe rrugeve te hyrjes	2 3	2	2	2	-2.2	
	Flora dhe Fauna- Demtim i vegjetacionit dhe largim i mundshem i faunes nga zona e kryerjes se punimeve si pasoje e ndikimit te zhurmes	3	2	3	2	-2.4	

	Ujerat siperfaqesore- Dherat dhe masat shkembore te gjeneruara nen veprimin e agjenteve atmosferike mund te levizin drejt trupave ujore te zones	2 5	1	3	2	-26	
	Toke dhe ujera - Rrjedhje e pakontrolluar e lengjeve ndotese (karburante) ne toke, ujerat siperfaqesore, dhe ujerat nentokesore	1 1	1	1	5	-1.8	
	Mjedisi human - Zhurme, pluhur dhe vibrim ne zonat e banuara prane zones se projektit, gjese se gjalle dhe prodhimit bujqesor.	2	3	3	1	-24	
	Pejsazh - Ndryshime estetike te pejsazhit	2	3	3	1	-20	

Vlerat totale numerike jane mesataret e pikeve te zones se ndikimit, mundesise se shfaqjes se ndikimit,

kohezgjatjes, shkalles se ndikimit dhe mundesise se zbutjes se ndikimit.

Kategorizimi total i ndikimit: asnje = 0, shume ivogel = 1, i vogel = 2, mesatar = 3, ilarte = 4, dhe shume i larte = 5

Ndikimet positive: "+," ndikime te pasigurta per pasojen "+/-," ndikimet negative cilesohen me "-".

Permbledhje e ndikimeve te mundshme

Ne kete paragraf eshte realizuar nje permbledhje cilesore e ndikimeve te mundshme ne

mjedis te veprimtarise se propozuar. Referuar tabelës se mesiperme, pothuajse te gjitha ndikimet, janë vlerësuar ne kategorine e ulet deri mesatare, qe tregojne se shkalla e ndikimit ne vlerat e mjedisit te zones eshte e kufizuar. Kjo eshte e kuptueshme edhe nga vete natyra e aktivitetit te propozuar, i cili ka si qellim shfrytezimin. Megjithate, Plani i Menaxhimit te Mjedisit (seksioni 5) permban masat parandaluese dhe kompensuese per do ndikim te mundshem te identifikuar dhe analizuar ne kete seksion.

- Si pasoje e zbatimit te projektit, i cili perfshin edhe punime te vogla minerare, dote mund te shfaqen ndikime te kufizuara ne sipërfaqen e tokës ku ata do te kryhen. Ne punimet minerare perfshihet edhe hapja e kanaleve, per rrjedhoje do te ndryshoje perkohesisht destinacioni i perdorimit te tokës ne sipërfaqen ku do te hapen kanalet. E njejtja gje mund te thuhet edhe per hyrjet e galerive dhe grykat e puseve. Ne raport nuk ka te dhena te detajuara mbi sipërfaqen e pergjithshme te kanaleve, por jepet volumi i germimeve prej 2,000 m³

- Duke marre nje mesatare prej 1 m per thellesine e germimit, maksimalisht sipërfaqja e ndikur do te jete 2000 m² ose 0,2 ha.

Volumi i germimit prej 2 000 m³ dote sistemohet ne ane te kanalit per t'u riperdorur perseri per mbylljen e tyre.

Gjithashtu si rezultat i aktivitetit te propozuar do te ndodhe shqetesim i shtreses se tokës dhe demtim i struktures se saj ne sipërfaqen e kryerjes se punimeve.

Ndikime te tjera te mundshme ne receptorin toke jane humbja e pjerresise se tokës ne rast se punimet do te kryhen ne shpate kodrinore apo malore dhe erozioni. Pjerresia e terrenit behet shkak qe grimcat e tokës nen veprimin e agjenteve klimatike, te shkeputen dhe levizin jashte zones se punimeve.

Gjithashtu ndikime do te kete edhe ne zhvillimin e proceseve te tokeformimit etj. ne sipërfaqen e prekur.

Se fundmi, si pasoje e perdorimit te makinerive te punes dhe automjeteve mund te ndodhe ndotje aksidentale e tokës nga rrjedhjet e lubrifikanteve dhe karburanteve per shkak te avarive te mekanikes.

- Duke gene se te gjitha mjetet e punes (perfshire ketu automjetet qe do te perdoren per transportin e fuqise punetore dhe paisjeve si dhe makinerite) qe do te perdoren per realizimin e punimeve minerare jane me motor me djegie te brendshme, mund te ndikohet cilesia e ajrit lokal, si pasoje e shkarkimeve ne mjedis te gazeve te djegies NO_x dhe SO_x, por kjo ndotje do te jete e shpemdare dhe e pakonsiderueshrne. Zona ne te cilen do te kryhen punimet e shfrytezimit eshte tipike rurale, mjaft e distancuar nga qendrat e banuara dhe pa burime te mirefillta ndotjeje si trafiku i shpeshte, industria apo aktiviteti ndertimor. Per pasoje cilesia e ajrit eshte mjaft e mire dhe mund ta absorboje teresisht sasine shume te paket te ndotjes nga shkarkimet e mjeteve motorike

Nga ana tjetër vete natyra e aktivitetit te propozuar dhe menyra e zgjedhur per shfrytezim, janë shkak i gjenerimit te zhurmave dhe nje sasie pluhuri, i cili dote jete me i ndjeshem ne stinen e thate. Gjithsesi zonat e banuara jane mjaft te distancuara dhe per rrjedhoje, zhurma dhe pluhuri nuk do te perbejne problem per komunitetet e zones. Po ki

shtu as vibrimet e mundshme. Me zbatimin e praktikave me te mira te menaxhimit do te parandalohen edhe ndikimet ne shendetin e punetoreve.

- Zhvillimi i aktivitetit te propozuar mund te shoqerohet edhe me ndikime ne ujerat sipërfaqesore te zone. Nese sasirat e dheut te gjeneruara si rezultat i germimeve, nuk sistemohen ne menyren e duhur, grimcat e tokes nen veprimin e agjenteve atmosferike mund te levizin drejt trupave ujore te zones duke shkaktuar ndotje te tyre.

Njekohesisht avarite e mekanikes mund te behen shkak per rrjedhje lubrifikantesh dhe karburantesh, te cilet nen veprimin e ujrave te shiut mund te shkaktojne ndotje te ujrave sipërfaqesore dhe nentokesore.

- Gjithashtu veprimtaria mund te shoqerohet me ndikim te bates se gjalle. Punimet e zbulimit kerkojne pastrimin e sipërfaqes nga vegetacioni. Siç u tregua edhe me lart ne kete paragraf, sipërfaqja e tokes qe do te ndikohet nga aktiviteti eshte mjaft e kufizuar (nese llogarisim edhe nje mesatare per puset dhe hyrjet e galerive ajo mund te arrije ne 0.4 ha). Per rrjedhoje edhe vegetacioni qe do te demtohet do te jete i pakët. Duhet theksuar se ne sektoret ku ultrabaziket zhvishen ne sipërfaqe vegetacioni mungon ose eshte shurne i pak i zhvilluar.

Keshtu qe nuk kemi humbje te vlerave floristike.

Njekohesisht mund te ndodhe demtim habitati dhe folesh te llojeve biologjike si dhe largim i faunes nga zona e projektit dhe perreth saj per shkak te zhurmes dhe pluhurit. Keto ndikime jane te pashrnangshme por masat per zbutjen e tyre mund te rezultojne te sukseseshme ne fazat e ndryshme te zhvillimit te biodiversitetit, veçanerisht gjate ciklit te riprodhimit. Keto masa dote mund te zbatohen me me teper efikasitet gjate vitit te dyte te shfrytezimit mbasi te jete njohur mire sjellja e biodiversitetit ne objekt.

- Gjenerim i mbetjeve urbane nga aktiviteti njerezor: kartona, bidona vaji, ambalazhe dhe qese plastike nga ambalazhet dhe aktiviteti i punonjesve.
Menjanimi i ketyre rreziqeve varet shume nga masat qe do te parashikohen dhe zbatohen ne Planin e Menaxhimit.

Zbutja e ndikimeve qe ne hartimin e projektit

Masat e meposhtme per zbutjen e ndikimeve ne mjedis sherbejne si kriter per hartimin e projektit te zbatimit me synimin qe ne perputhje me karakteristikat e zones se projektit te minimizohen ndikimet e pergjithshme te tij:

- Perdorimi sa me teper te jete i mundur i rrugeve e gzistuese;

Te gjitha automjetet e projektit, duhet te kontrollohen periodikisht dhe mirembahen ne kushte teknike optimale per te minimizuar shkarkimet ne mjedis, zhurmat dhe dridhjet;

- te ndalet qarkullimi i automjeteve me rrjedhje deri sa te riparohen dhe te mos shkaktojne ndotje ne mjedis;
 - zbatojne kufizimet e shpejtesise se mjeteve te cilat duhet te perputhen me percaktimet ne çdo zone te projektit apo dhe rrugeve te transportit, llojit te mjeteve etj.

Informacion per kohezgjatjen e ndikimeve te identifikuara

Ne kete objekt ndikimet jane shume te vogla si ne ndotje etj por kohezgjatja e ketij projekti eshte per nje afat 3 vjeçar

TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDESHME HAPSINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS

Ndikimi ne mjedis eshte ndikimi vetem per zonen dhe siperfaqen e objektit pasi nuk demton perreth .

MUNDESITE E NDIKIMIT NE MJEDISIN NDERKUFITAR

Zhvillimi i aktivitetit ne kete objekt do te behet ne nje siperfaqe shume te vogel(ne varesi te rezultateve ne zbulimin e mineralit te kromit), nuk perben probleme ndikimi ne mjedisin nderkufitar.

MUNDESIA E REHABILITIMIT

Plani i monitorimit do te konsistoje ne :

- *Monitorimi i parametrave gjeometrike te kanaleve si: pjeresi, lartesia, kendi i skarpates, pjeresia e sheshit te punes si dhe parametrave gjeometrike te parshikuar ne projekt.*
- *Monitorimi i sjelljes se formacioneve ne kufijte e jashtem te shpimeve dhe marrja e masave per parandalimin e levizjeve te mundeshme si shkarje, shembje ose vithisje .*
- *Monitorimi i zones se mundeshme te shperndarjes se pluhurit gjate aktivitetit te shfrytezimit ku do perdoret uji*
- *Monitorimi i parametrave fizike dhe dinamike te shperndarjes se pluhurit dhe marrja e masave perkatese te parashikuara ne projekt, per parandalimin e tij*
- *Monitorimi i sjelljes se bimesise ekzistuese ne zonen per rreth zoness dhe marrja e masave per parandalimin e demtimit te tyre*
- *Monitorimi i siperfaqeve te mbushura me material dhe toke vegjetale per parandalimin e shplarjeve, gryerjeve, krijimin e gropave etj. Atje ku evidentohen demtime te kesaj zone do te merren masa per riparimin e tyre .*
- *Monitorimi i siperfaqeve te mbjella, pemeve dhe bimeve te kultivuara, ecurise normale e mbirjes dhe zhvillimit te tyre. Ne rastet kur verehet se ka demtime merren masa per zevendesime me fidane te rinj. Monitorimi i çdo siperfaqe te mbjelle do te vazhdoje per nje periudhe 4 vjeçare, kohe gjate se ciles bimet kane marre nje zhvillim te konsiderueshem dhe nuk kane me nevojë per sherbime.*

Subjekti mer persiper sigurimin e ecurise normale te punes dhe ruajtjen e vazhdueshme te mjedisit deri ne mbylljen e aktivitetit

Subjekti, gjithashtu, do te kete lidhje te vazhdueshme me Agjensine Rajonale te Mjedisit Diber , prane se ciles do te informoje periodikisht per mbarevajtjen e punes si gjate shfrytezimit ashtu dhe per minitorimn e parametrave te me siperm .

STUDIO " OSKEOLA" SHPK

LEK BICUKU

